Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr.Br. 289/19
Date/Datum. 23.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 289/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "PMC sh. p. k & NTP Adri Zaun Rrethoja", kundër njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: "Ndërtimi i serave për fermer" me nr. të prok: 615-19-942-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës, më datën: 04. 07. 2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si te bazuara ankesat e operatoreve ekonomik "PMC sh. p. k & NTP Adri Zaun Rrethoja", kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i serave për fermer" me nr. të prok: 615-19-942-521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i serave për fermer" me nr. të prok: 615-19-942-521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohen pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 08.03.2019
Hapja e ofertave është bërë me dt: 02.04.2019
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës 24.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm 24.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim 29.05.2019
Autoriteti Kontraktues me datën 31.05.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "PMC sh. p. k & NTP Adri Zaun Rrethoja", si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07. 06. 2019 me numër 289/19 kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull "Ndërtimi i serave për fermer" me nr. të prok: 615-19-942-521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujeves.
Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,
- Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,
- Neni 60, Kriteret pre Dhënien e Kontratës
- II-Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik
- Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues dhe eksperti profesional në raportin e dt: 17.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues nuk e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë në pajtueshmëri me Nenin 60 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së tenderuesit NTP "Liria" fitues për këtë kontratë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i papërgjegjshëm dhe duke diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender. Me këtë rast nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë tenderuesin Ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", Ulpianë, 10000, Prishtinë edhe pse ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët prej 112.565,00 €.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 56)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse

duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin e Tenderuesit të shpallur fitues, që e kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Përzgjedhjen e fituesit për këtë tender në pajtueshmëri me LPP, Nenin 56- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, Citojmë paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij Neni:

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji

Duke u bazuar ne nenin (51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes) Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kritere të përzgjedhjes që i ka caktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë, sepse e ka shpallur Tenderuesin NTP "Liria", i cili nuk i ka plotësuar nenet 68 dhe 69 të LPP, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (Nr. i nenit 8.1 & 8.2) dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) faqe 12 në DT.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

• Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kam konstatuar se nuk e ka plotësuar nenin 68 të LPP, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (Nr. i nenit 8.1 & 8.2) Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit. Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit NTP "Liria"në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar Dëshmia e kërkuar dokumentare, Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, ne pajtueshmëri me nenin 68 pika 1.5, Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, por ka afruar dëshmi mbi Gjendjen e përgjithshme te deklarimeve dhe transaksioneve tjera për vitin 2012 deri me 2018 si dhe Formularët e Deklarimit në TVSH për vitin 2018, por e dhe me to nuk i plotëson, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht te dëshmoj se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00 euro, sepse nga to shihet se ka qarkullim për tri vitet e fundit vetëm 188,461.10 € (Viti 2016 = 48,780.30 €, viti 2017 =127,123.29 € dhe viti 2018 = 12,557.50 €), që nuk e plotëson qarkullimin e kërkuar financiar, për këtë arsye NTP "Liria" është dashtë të shpallet e papërgjegjshme.

•Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kam konstatuar se nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit, (Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE minimumi në vlerë 240, 000.00euro

2. AK ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne FDT te dosjes se tenderit ne paragrafin; 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeçare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar punët e kryera,

		realizuara në tre vitet e fundit	shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit
		OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtorë. a) një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit	Lista me numër të punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e noterizuar, cv-ja, kontrata e punës Nëse inxhinieri nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshje për angazhim në këtë projekt
		Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt	Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër)

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit NTP "Liria"në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar Dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare, për: Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240, 000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit.

Dëshmitë e dorëzuara në tender, me rastin e kontrollimit e tenderit të NTP "Liria" të propozuar për kontratë, mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale duke filluar nga Lista e kontratave të përfunduara me sukses nga firma NTP "Liria", në të cilën i ka paraqitur projektet e realizuara por të cilat janë të gjitha furnizime.

Kjo listë nuk i plotëson dëshmitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, sepse është kërkuar që për këto projekte të saktësojë punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit.

Andaj oferta e tenderuesit NTP "Liria" është e papërgjegjshme në kuptim të dispozitave të LPP-se dhe si e tillë duhet të eliminohet nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.

Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kam konstatuar se nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit, (Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt).

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit NTP "Liria"në tenderin e tij, kam konstatuar se nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare, për:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër).

Dëshmitë e dorëzuara në tender, me rastin e kontrollimit e tenderit të NTP "Liria" të propozuar për kontratë, mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale për, Lista e pajisjeve - mjeteve të punës, nuk i plotëson kërkesat dhe nuk është në përputhshmëri kërkesën në dosjen e tenderit, pasi nuk i ka bashkangjitur kësaj liste kontrata të kontraktuara (me qira) ose të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër për pronësi.

Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, pretendimet e tenderuesit ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja" se Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, nuk është bërë në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", janë të qëndrueshme.

Përgjigje në pretendimin e lartcekur (Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se nuk është zbatuar si duhet Nenin 60 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Kriteret për Dhënien e Kontratës) është i bazuar, sepse nuk është respektuar ky nen ku kërkohet (citojmë) :

LPP ne nenin 60 paragrafi 1. dhe nen paragrafin 1.1 përcakton:

2. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët:

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 60, duke e shpallur tenderuesin e pa përgjegjshëm NTP "Liria" fitues.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik)

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit, të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, dhe Nenit 41 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik po citoj:

41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyrë komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.
Vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktues për këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit, nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë, ndërsa ky vlerësim i ofertave ka zgjat afër dy muaj, që është plotësisht kundërligjor.

Se Autoriteti Kontraktues, nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, dhe Nenit 41, e kemi konstatuar edhe me rastin e publikimit të në njoftimit respektivisht dokumentin B58-Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.05.2019, nuk e përcakton qartë fituesin, ku diku fitues është NTP "LIRIA" e diku fitues është kozorciumi "Liria" SHPK & Eurosera, kurse ne procesverbali i hapjes së tenderit dhe në formularin e dorëzimit të tenderit Emri i kompanisë është: N.T.P. " LIRIA ", ZAHIR PAJAZITI 71, -, PODUJEVË, Kosovë.

Duke u bazuar ne nenin (neni 59 par. 4 të LPP-së, dhe Nenit 41) Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kritere të përzgjedhjes që i ka caktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë, sepse e ka shpallur Tenderuesin NTP "Liria", i cili nuk i ka plotësuar nenet 66 të LPP, Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale (Nr. i Nenit 7.1 & 7.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) faqe 12 në DT.

- Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale
- Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese

Andaj, pretendimet e Tenderuesin Ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja" janë të bazuara sepse Tenderuesin NTP "Liria "në tenderin e tij nuk ka dorëzuar dokumentet bazë të përshtatshmërisë profesionale:

1. Certifikata e biznesit (kopje)
2. Certifikata e numrit fiskal (kopje)
3. Certifikata e TVSH (kopje)

Sipas udhëzuesit operativ për prokurim publik autoriteti kontraktues e ka të drejtën të ia kërkoj operatorit ekonomik, por një gjë të tillë autoriteti kontraktues nuk e ka bërë.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e tenderuesit ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet 7, 56, 59, dhe 60 LPP, janë të qëndrueshme.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që ankesa e Tenderuesit ankues Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek më lart), njëherësh propozoj që të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik OE ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 21 qershor 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 24 qershor 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për anulim të aktivitetit, ankesat e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues profesional, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë të OE-së së parë ankues deklaroj: "E kemi lexuar raportin e ekspertes shqyrtuese dhe pajtohem plotësisht te datës 17.06.2019 ku ekspertja ka shqyrtuar te gjitha pretendimet ankimore dhe ne meny profesionale ka dhen mendim qe te aprovohet ankesa si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësueses së AK-së znj. Jashari i cili deklaroj: "Edhe ne si Autoriteti Kontraktues qëndrojmë prapa vendimit tone, ku sipas kërkesave te Autoriteti Kontraktues OE i shpallur

fitues ka plotësuar te gjitha kriteret ku është kërkuar referencat minimumi 240.000 euro OE i shpallur fitues ka ofruar kontrata dhe referenca sipas kërkesave tona. Gjithashtu ka plotësuar edhe kriterin i cili ka qenë 15 punëtor dhe ka sjellë kontratat me listën e punëtoreve ka qenë edhe kërkesa për menaxherin e projektit ku edhe aty ka sjell kontratën dhe CV, gjithashtu OE ka plotësuar kriterin për mjetet e punës, Qëndrojmë prapa vendimit tone te cilin OE i ka plotësuar kriteret dhe ne si Autoriteti Kontraktues kemi menduar ruajtjen e buxhetit ku OE fitues ka qene me çmim 119.217 ndërsa OE ankues ka qene 132.826.70 euro e qe do te thotë diferenca prej 13.609.07 euro".

Kryetari i Panelit e pyeti përfaqësuesen e AK-së: A e ka plotësuar qarkullimin vjetor për 3 vitet e fundit prej 320.000?. Përfaqësuesja e AK-së përgjigjët: PO.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkojmë qe ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kriteret e përzgjedhjes që i ka caktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë, sepse e ka shpallur tenderuesin NTP "Liria", i cili nuk i ka plotësuar nenet 68 dhe 69 të LPP, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (Nr. i nenit 8.1 & 8.2) dhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (nr. i nenit 9.1 & 9.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) faqe 12 në DT.

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "Liria" nuk ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentare, Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, ne pajtueshmëri me nenin 68 pika 1.5, Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, por ka afruar dëshmi mbi gjendjen e përgjithshme te deklarimeve dhe transaksioneve tjera për vitin 2012 deri me 2018 si dhe Formularët e Deklarimit në TVSH për vitin 2018, por edhe me to nuk i plotëson, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht te dëshmoj se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00 euro, sepse nga to shihet se ka qarkullim për tri vitet e fundit vetëm 188,461.10 € (Viti 2016 = 48,780.30 €, viti 2017 =127,123.29 € dhe viti 2018 = 12,557.50 €), që nuk e plotëson qarkullimin e kërkuar financiar, për këtë arsye NTP "Liria" është dashtë të shpallet e papërgjegjshme. Prandaj paneli shqyrtues konstaton se duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit NTP "Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se sepse i njëjti nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (Nr. i Nenit 9.1 & 9.2). Seksioni II. FLETA E TË

DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 12 në Dosje të Tenderit, (Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE minimumi në vlerë 240, 000. 00euro. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme dokumentare, për: Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240, 000.00 euro. Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit. Dëshmitë e dorëzuara në tender, me rastin e kontrollimit e tenderit të NTP "Liria" të propozuar për kontratë, mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale duke filluar nga lista e kontratave të përfunduara me sukses nga firma NTP "Liria", në të cilën i ka paraqitur projektet e realizuara por të cilat janë të gjitha furnizime. Kjo listë nuk i plotëson dëshmitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, sepse është kërkuar që për këto projekte të saktësojë punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit.

Paneli shqyrtues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e FDT për Kapacitetin teknik dhe profesional- Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt (Dëshmia e kërkuar dokumentare- Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër), pasiqë nga dëshmitë e dorëzuara në tender, me rastin e kontrollimit e tenderit të NTP "Liria" të propozuar për kontratë, mbi plotësimin e kërkesës për mundësitë teknike dhe profesionale për Lista e pajisjeve - mjeteve të punës, nuk i plotëson kërkesat dhe nuk është në përputhshmëri kërkesën në dosjen e tenderit, pasi nuk i ka bashkangjitur kësaj liste kontrata të kontraktuara (me qira) ose të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër për pronësi.

Paneli shqyrtues konstaton se Vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktues për këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit, nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë, ndërsa ky vlerësim i ofertave ka zgjat afër dy muaj, që është plotësisht kundërligjor.

Paneli shqyrtues konstaton se në dokumentin e AK-së B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.05.2019, nuk e përcakton qartë fituesin, ku diku fitues është NTP "LIRIA" e diku fitues është kozorciumi "Liria" SHPK & Eurosera, kurse ne procesverbali i hapjes së tenderit dhe në formularin e dorëzimit të tenderit Emri i kompanisë është: N.T.P. " LIRIA ", ZAHIR PAJAZITI 71, - PODUJEVË, Kosovë.

Duke u bazuar ne nenin (neni 59 par. 4 të LPP-së, dhe Nenit 41) Autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kritere të përzgjedhjes që i ka caktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë, sepse e ka shpallur Tenderuesin NTP "Liria", i cili nuk i ka plotësuar nenet 66 të LPP, Kërkesat e përshtatshmërisë

profesionale (Nr. i Nenit 7.1 & 7.2). Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) faqe 12 në DT.

- Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale
- Në mënyrë që të dështmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dështmuese

Andaj, pretendimet e OE ankues "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja" janë të bazuara sepse OE i rekomanduar NTP "Liria "në tenderin e tij nuk ka dorëzuar dokumentet bazë të përshtatshmërisë profesionale:

1. Certifikata e biznesit (kopje)
2. Certifikata e numrit fiskal (kopje)
3. Certifikata e TVSH (kopje)

Sipas udhëzuesit operativ për prokurim publik autoriteti kontraktues e ka të drejtën të ia kërkoj operatorit ekonomik, por një gjë të tillë autoriteti kontraktues nuk e ka bërë.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, andaj duke e pasur parasysh konstatimet edhe te ekspertit shqyrtues profesional, paneli shqyrtues vlerëson se pretendimet e tenderuesit ankues, Grupi i Operatorëve ekonomik "PMC"SH.P.K. & N.T.P. "Adri Zaun- Rrethoja", se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet 7, 56, 59, dhe 60 LPP, janë të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Podujevë

1x1 OE- "PMC shpk& NTP Adrizaun Rrethoja",

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.